

VENDIM
Nr. 918, datë 11.11.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VAQARR, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit”, të vendimit nr.8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, dhe të vendimit nr.85, datë 30.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, që do të realizohet në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës të bëhen në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, në shumën 47 368 594 (dyzet e shtatë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 47 368 594 (dyzet e shtatë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh, do të përballohet nga zëri “Fondi për rindërtimin”, i miratuar për vitin 2020.

5. Shkëmbimi i pasurive private të llojit “ndërtesë” me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme, të bëhet referuar legjislacionit në fuqi, cilësimeve në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe marrëveshjeve/kontratave që janë lidhur e do të lidhen ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Tiranë, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

8. Bashkia Tiranë të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, e të bëjë shkëmbimin e pronës, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme të

jetë në përfundim të realizimit të projektit për zhvillimin në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë.

10. Bashkia Tiranë i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit e të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall, ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të bëhet regjistrimi i barrës ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privat/ë që ka/në pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë e kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet, bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet në favor të pronarit privat.

11. Bashkia Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, t'i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive pronë private të shpronësuara, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

12. Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, të pasqyrojë në regjistrat kadastralë ndryshimin e kategorisë së resursit të pasurive të paluajtshme nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në kategorinë “tokë urbane” “truall”.

13. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimi i punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

14. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara.

15. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

16. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Tiranë, dhe Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE SHKËMBEHEN, PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "ZONË TË RE PËR ZHVILLIM", NJËSIA ADMINISTRATIVE "VAQARR", BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM DHE/OSE KOMPENSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË										VLERA TOTALE (lekë)	Kompensim në vlerë/Shkëmbim	KONFIRMUAR/SHËNIME		
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas	Lloji I pas.	Sip.Truall/Arë Totale m ²	Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim tokë "arë"			Sip. Ndërtesë Totale (m2)	Ndërtesë banimi (shtëpi)					Ndërtesë jo banimi	Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, e ASHK – së	Shënime në Kartelë
								Sip e prekur (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		Sip e prekur (m ²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ASHK (l/m ²)	Vlera (lekë)					
PRONË PRIVATE																						
1	Lista e Bashkepronareve Taku			3712	81/10	Truall	7,895.0	3758	528	1,984,224					0		0	1,984,224	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020	Në përshkrimin e veçantë thuhet: Dëshmi trashëgimie nr. dok 1378, nuk është sjellë certifikatë origjinale. Nuk është lëshuar certifikatë.	
2	Bedri	Hysen	Taku	3712	81/3	Arë	3,000.0				3,000.0	448	1,344,000.0		0		0	1,344,000	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020	Në seksionin E ka shënimin:Vendoset masa e sekuestros konservative, nr. dok. 1902, dt. 11.03.2009 dhe nr. 2209, dt. 29.03.2011	
3	Riza/Altin	Qamil Riza	Taku/Taku	3712	79/8	Truall+ ndërtesë	82	82	528	43,296				82.00	82	82,466	6,762,212	6,805,508	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.09.2020		
4	Shpëtim Reshat Ylli Rrahime	Selim Telha Telha	Taku Taku Taku	3712	79/15	Truall	380	380	528	200,640					0		0	200,640	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020		
5	Riza Gentjana Altin	Qamil Riza Riza	Taku Taku Taku	3712	79/6	Truall+ ndërtesë	169	169	528	89,232				169.00	169	82,466	13,936,754	14,025,986	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020 si edhe nr. 6617/1, dt. 29.09.2020		
6	Zyra	Sami	Mullaymeri	3712	79/13	Truall+ ndërtesë	152.5	152.5	528	80,520				152.5	152.5	82,466	12,576,065	12,656,585	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.09.2020		
7	Dashurije	Dervish	Mullaymeri	3712	79/10	Truall+ ndërtesë	59.7	59.7	528	31,522				59.70	59.70	82,466	4,923,220	4,954,742	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.09.2020		

8	Lumturi	Baki	Taku	3712	79/11	Truall+ ndërtësë	26.5	26.50	528	13,992				26.50	26.50	82,466	2,185,349	2,199,341	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.09.2020	
9	Hamdi	Beqir	Taku	3712	79/2	Truall	1450	1450	528	765,600				0	0	0	0	765,600	Kompensim në vlerë	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020	
Kompensimi në vlerë (Lekë)							6,077.70		528	3,209,026	3,000.00	448	1,344,000	489.70	82,466	40,383,600	44,936,626				
PA INFORMACION NË ASHK																					
1	Pa informacion			3712	79/18	Truall		4606	528	2,431,968								2,431,968		shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	
Kompensimi në vlerë (Lekë)							4606			2,431,968								2,431,968			
NË PROCES LEGALIZIMI NË ASHK																					
1	Shpëtim	Bedri	Taku			objekti nr. 1										139.60			139.6	Përjashtim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/8, datë 31.08.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM – së nr. 8, dt. 06.01.2020	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020
2	Dilaver	Bedri	Taku			objekti nr. 2										64.50			64.5	Përjashtim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/9, datë 31.08.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM – së nr. 8, dt. 06.01.2020	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020
3	Ylli	Telha	Taku			objekti nr. 4										132.90			132.90	Përjashtim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/7, datë 31.08.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM – së nr. 8, dt. 06.01.2020	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020
4	Bedri	Hysen	Taku			objekti nr. 5										1,088.50			1,088.50	Përjashtim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/6, datë 31.08.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM – së nr. 8, dt. 06.01.2020	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020 shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.08.2020
Totali																1,425.50			1,425.50		
SHTET																					
1	Shtet(Pa informacion në sistemin elektronik)			3712	198	Rrugë		726.00	0	0								0	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	
2	Shtet			3712	236	Rruge	2,500.00	1,281.00	0	0								0.00	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	
3	Bashkia Tiranë			3712	79/17	Truall	4,060.74	4,060.74	0	0				1,401.27				1,401.27	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	
4	Shtet			3712	79/7	Truall	56	56	0	0				56.00				56.00	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020	
5	Shtet			3712	79/12	Truall	33.30	33.30	0	0				33.3				33.3	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020	
6	Shtet			3712	207	Kanal	1700	138	0	0								0	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	
7	Shtet			3712	242	Rruge	800.00	157.00	0	0								0	0	shkresa nr.	

																			prot. 3134/1, dt. 20.07.2020				
8	Shtet	3712	68/9	Truall	800.00	800.00	0	0										0	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020			
9	Bashkia Tirane	3712	68/10	Truall	1,440.00	1,440.00	0	0					657					657	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020			
10	Shtet	3712	68/12	Truall	588	588	0	0										0	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020			
11	Bashkia Tirane	3712	68/11	Truall	672	672	0	0					226					226	0	shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.02.2020			
12	Shtet	3712	68/6	Shesh	4400	1,275.00	0	0										0	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	Në seksionin D ka shënimin: Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa nr nr. pas 6/68 – ND, vol. 13, fq. 246, leje legalizimi.		
Totale sip e prekur m2						11,227.04												2373.57					
TË MENAXHUAR ME LEJE NDËRTIMI																							
1	Llazar	Sotir	Angjeli	3712	81/12	Truall	4720	77.00	0	0								1,533.00	0	0	0	shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.07.2020	Në seksionin Përkthim I veçantë ka shënimin: Mbi këtë truall sipas lejes ndërtimit nr. 52, dt. 17.01.1999 të KRRK të rrethit Tirane është ndërtuar linjë për përpunim frutash, zyrë, pikë karburanti dhe depo karburanti. Në seksionin E ka shënimin: Pasuria në favor të Banka Credins SHA për shumën 700.000 Euro dhe 56.000.000 (KHIP nr. 105/73619 dhe 10566/3618, dt. 20.11.2017) Pasuria bllokohet në favor të Banka Credins SHA për shumën 815.000.000 lekë. (KHIP nr. 8204/2773, dt. 19.10.2018) Pasuria bllokohet në favor të Banka Credins SHA për shumën 180.000.000 lekë. (KHIP 4408/1517, dt. 13.05.2019 Në favor të Banka Credins SHA për shumën 410.000.000 lekë (4432/1534, dt. 13.05.2019)
Totale sip e prekur m²						77.00																	
Totali																	47,368,594						

- Shënime:**
- Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresat nr. 228/1 prot, datë 14.1.2020, nr. 228/5 prot, datë 19.2.2020, nr. 3134/1, datë 20.7.2020, nr. prot. 3134/5, datë 31.8.2020, të ASHK – së, Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.
 - Për vlerësimin e pasurive të llojit truall jemi referuar VKM – së nr. 89, datë 3.2.2016
 - Për vlerësimin e pasurive të llojit "ndërtese", çmimi/m² është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, si më poshtë vijon:
 - me funksion "banimi" është bërë sipas shkrësës nr. 6617/1, datë 29.9.2020, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të ASHK – së.
 - Përjashtimi nga legalizimi i objekteve, të vetëdeklaruar është bërë me shkresat nr. prot. 3134/6, nr. prot. 3134/7, nr. prot. 3134/8 dhe nr. prot. 3134/9, datë 31.8.2020, bashkëlidhur shkrësës nr. prot. 3134/5, datë 31.8.2020, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të ASHK – së